



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Ac.nr.352/2019

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Hunaida Pasuli – Kryetare e kolegjit, Gani Avdiu dhe Faton Ademi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit H.R. nga f.sh. ..., Komuna e Skenderaj të cilin e përfaqëson i autorizuari SH.I. avokat në Skenderaj, kundër të paditurës Komuna Skenderaj- Drejtoria Komunle e Arsimit, Rr.”28 Nëntori”- Skenderaj, të cilën e përfaqëson Enver Qerkini, për shkak të kompensimit të tri pagave jubilarë dhe tri pagave përcjellëse për në pension, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë –Dega në Skenderaj, C.nr.427/2018 të datës 04.12.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.01.2021 mori këtë:

### A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e të paditurës Komuna Skenderaj - Drejtoria Komunale e Arsimit Rr.”28 Nëntori”-Skenderaj, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë- Dega- Skenderaj, C.nr.427/2018 i datës 04.12.2018, VËRTETOHET.

### A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.427/2018 i datës 04.12.2018, ka vendosur si në vijim:

I.APROVOHET si e bazuar kërkespacia e paditësit H.R. nga f.sh.... Komuna Skenderaj.  
II.DETYROHET e paditura Komuna e Skenderaj-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit në emër të pagave jubilarë t’ia paguajë shumën prej 829.00 €(tetëqind e njëzetë e nëntë euro), si dhe në emër të tri pagave përcjellëse në pension, t’ia paguajë shumën prej 1,660.00 € (njëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë euro), gjithsej shumën e përgjithshme prej 2,489.0 E (dymijë e katërqind e tetëdhjetë e nëntë euro), ne afatin prej 7 dite, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

III.-DETYROHET e paditura që në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguaj paditësit shumën prej 269,00 €, brendaafatit 7 ditor pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit më dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i të paditurës, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ankesën ta aprovoj si të bazuar, ashtu që aktvendimin e atakuar ta prishë dhe çështja ta kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi H.R. nga f.sh. ... Komuna Skenderaj, me datë 13.11.2018, ka ushtruar padi për shpërblim jubilar dhe kompensimin e pagave për përcjellje në pension, kundër të paditurës Komuna Skenderaj-Drejtoria Komunale e Arsimit Skenderaj, me arsyet dhe kërkesë si në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë dhe me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka zhvilluar procedurën për administrimin e provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse. Mbi bazën e provave të nxjerra ka vlerësuar se kërkesa nga padia është e bazuar dhe të njëjtën e aprovoi, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit gjykata ka parashtruar se paditësi ka mbi 42 vite përvojë pune te e paditura, përkatësisht paditësi ka qenë në marrëdhënie pune deri më datë 15.12.2017, - ku sipas fuqisë ligjore është pensionuar. Mbi këtë gjendje faktike të vërtetuar dhe me referim në dispozitat me 4 par2 të Ligjit të Punës (NR.03/L-212) dhe në dispozitat e nenit 35 par.8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të dt. 18.04.2017, e cila ka qenë në fuqi në kohën e pensionimit të paditësit, gjykata e detyroi të paditurën që paditësit t'ia paguaj pagat në emër të përcjelljes në pension si dhe në emër të shpërblimit jubilar. Gjykata lidhur me lartësinë e pagave që paditësi ka realizuar tre muajt e fundit mori parasysh listën e pagave për muajin shtator, tetor, nëntor, të vitit 2017 me Kod 10-93675-643-0912, lëshuar nga organi i punësimit për paditësin. Këtë vendim gjykata e bazoi në dispozitën e nenit 90 të Ligjit Nr.03L-212 të Punës dhe dispozitave të nenit 143,449,452,476, të LPK-së, gjersa vendimin për shpenzimet e procedurës kontestimore e bazoi në nenin 449 dhe 452 par 1. të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye

se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të së drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i qartë, i ekzaminueshëm dhe në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në këtë kuptim, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se aktgjykimi i ankimuar është në përputhje të plotë me kërkesat ligjore nga neni 160 i LPK-së, meqë në dispozitivin e tij gjykata e çështjes ka treguar qartë se cila është kërkesa kryesore që aprovohet, ndërsa aktgjykimi përmban edhe bazën ligjore lidhur me vendimin për kërkesën kryesore, si dhe për shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe disa fakte vendimtare nuk kanë qenë kontestuese. Nuk ka qenë kontestuese në mes palëve se paditësi për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare është pensionuar më datë 15.12.2017, (pra në periudhën kohore kur ishte në zbatim Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës dhe Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017). Nuk ishte kontestues që paditësi tek e paditura ka përvojë pune në kohëzgjatje prej 42 vite, i cili fakt provohet edhe nga vërtetimi i lëshuar nga ShFMU "Enver Haliti" në ... me datë 07.11.2018 dhe vërtetimi i lëshuar nga shkolla fillore "Azem Bejta" në Prekaz i Epërm me nr.107/17, datë 24.10.2018. Rrjedhimisht, me aprovimin e kërkesëpadisë, rezulton se gjykata në raport me faktet e rastit drejtë ka aplikuar dispozitat e ligjit material, për arsye se referimi i aktgjykimit kryesisht është bërë në dispozitat e nenit 38 të Kontratës Kolektive të Arsimit, e cila kontratë përcakton se punëtorët (anëtar të SBASHK-ut) që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësinë e tri pagave sipas mesatares së pagave të fundit, ndërsa shpërblimi jubilar vlerësohet varësisht nga përvoja e punës. Duke qenë se në rastin konkret nuk ishte kontestues që paditësi kishte mbi 40 vite përvojë pune, pandaj gjykata e çështjes, në raport me këtë gjendje faktike, ka zbatuar drejtë dispozitën nga neni 35.pika 8.4, duke e detyruar të paditurën që paditësit në emër të shpërblimit jubilar t'i paguaj 150% të një page bazë. Nga arsyet e parashtruara aktgjykimin e atakuar e përkrah si të ligjshëm edhe gjykata e shkallës së dytë, gjersa pretendimet ankimore në drejtim të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, i vlerësoi si krejtësisht të pambështetura.

Sa i përket pretendimeve ankimore që kërkesa për kompensimin e pagave në emër të shpërblimit jubilar është kërkesë e parashkruar, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se ky pretendim është i paqëndrueshëm, për arsye se nga provat që gjenden në shkresat e lëndës vërtetohet që padia në rastin konkret është paraqitur brenda afatit ligjor të përcaktuar në

dispozitën e nenit 87 të Ligjit të Punës, e cila dispozitë shprehimisht përcakton afatin tre vjeçar të parashkrimit të kërkesave në para nga marrëdhënia e punës.

Vendimi për shpenzimet e procedurë është në përputhje me dispozita e LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odes së Avokatëve si dhe me udhëzimin administrativ për unifikimin e taksave gjyqësore.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), e), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Ac.nr.352/2019, me datë 22.01.2021

Kryetarja e kolegjit - Gjyqtarja

Hunaida Pasuli